



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО - UNIVERSITY OF TETOVA

Bul. "Ilinden" p.n. 1200 Tetovë | Tel: +389 44 356 500 | Fax: +389 44 356 222
e-mail: international@unite.edu.mk | www.unite.edu.mk

NJOFTIM

Njoftohen të interesuarit se **Buletini nr. 137** i Universitetit të Tetovës është publik dhe i njëjti mund të shikohet nga të interesuarit te Dekanët e fakulteteve të Universitetit të Tetovës.

Buletini do të jetë publik duke filluar nga 27.11.2018 deri më 11.12.2018.

Tetovë, 27.11.2018



REFERAT

PËR ZGJEDHJEN-RIZGJEDHJEN E MËSIMDHËNËSVE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE NË FUSHËN E GJUHËSISË GJERMANE

NË PROGRAMIN STUDIMOR GJUHË DHE LETËRSI GJERMANE TË FAKULTETIT FILOLOGJIK TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

Deri te:

Këshilli i Rektoratit i Universitetit të Tetovës

Në bazë të propozimit të Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit filologjik të Universitetit të Tetovës, nr. 18-1396/1, të datës 05.11.2018, lidhur me konkursin për zgjedhjen/rizgjedhjen e mësimdhënësve në thirrje mësimore-shkencore, të shpallë në të përditshmet “Koha” dhe “Nova Makedonija” të datës 19.10.2018, si dhe në web-faqen e Universitetit www.unite.edu.mk, Këshilli i rektoratit, në mbledhjen e mbajtur më 21. 11. 2018 solli vendim 02-5077/1, për formimin e Komisionit recensues në përbërje:

1. **Prof. dr. Arbër Çeliku (kryetar)** - profesor ordinar
2. **Prof. dr. Brikena Kadzadej (anëtar)** - profesor inordinar
3. **Prof. dr. Majlinda Nuhiu (anëtar)** – profesor inordinar

Komisioni recensues, duke qenë falënderues për besimin e dhënë, ka nderin të paraqesë këtë:

R A P O R T

Konkursi publik është shpallë për 1 mësimdhënës për lëndët: Metodika e gjuhës gjermane, Hyrje në gjuhësinë gjermane dhe historia e vendeve gjermanishtfolëse dhe, pasi Komisioni vlerësues e shqyrtoi elaboratin e akredituar të programit studimor: Gjuhë dhe letërsi gjermane në Universitetin e Tetovës, propozon ndryshimin formal të lëndëve në përputhje me planin dhe programin e tanishëm mësimor si më poshtë:

1. Metodika e mësimdhënies së gjuhës gjermane,
2. Hyrje në gjuhësinë gjermane, si dhe
3. Historia dhe kultura e vendeve gjermanishtfolëse

Në konkursin publik për zgjedhjen e 1 mësimdhënësi për lëndët e sipërpërmendura janë paraqitur 2 kandidatë:

1. Dr. sc. Gjuliano Iseini
2. Dr. sc. Drita Xhemaili

Në vazhdim renditen të dhënat personale, arsimi i kryer dhe përvoja akademike dhe aktiviteti shkencor i çdo kandidati veç e veç:

1. Dr.sc. Gjuliano Iseini:

TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Kandidati Dr. sc. Gjuliano Iseini ka lindur më datë 10.06.1969 në Forinë, Gostivar, Republika e Maqedonisë. Shkollën fillore dhe të mesme i ka kryer në Gostivar. Më 03 mars 1995 ka diplomuar në Fakultetin Filologjik të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, në Katedrën e gjuhës dhe letërsisë gjermane, me notë mesatare të studimeve **8.95**, dhe ka fituar titullin akademik: *Profesor i gjuhës dhe letërsisë gjermane dhe filolog i diplomuar..*

Gjatë studimeve ka marrë pjesë në hulumtimet dialektologjike studentore në Frajburg, dhe në vitin 1995 ka vizituar shkollën verore të gjuhës gjermane në Seminarin e gjuhës gjermane në Bernë, Zvicër. Gjithashtu ka marrë pjesë në seminare të gjuhës gjermane për mësimdhënës, që gjermanishten nuk e kanë gjuhë amtare dhe në konsultat e Shoqatës së përkthyesve në nivel Federativ në Cyrih, Zvicër. Nga 15 deri 25 maj 2000, ka marrë pjesë në seminarin e Shoqatës së arsimtarëve të gjuhës gjermane në Maqedoni në organizim të DAAD Beograd, në Shkup.

Nga 1995 punon përkthyes i autorizuar në Zyrën Federale të Migracionit në Bernë, si dhe në administratën kantonale në Bernë, Cyrih dhe Soloturn, Zvicër.

Në vitin 1996 është pajisur me licencën e përkthyesit gjyqësor në Gjykatën Themelore në Gostivar, R. e Maqedonisë.

Studimet e magjistraturës në lëmin e gjuhësisë – drejtimi: Gjermanistikë i ka kryer më 10. 10. 2006 në Fakultetin Filologjik “Blazhe Koneski” në Shkup (**nota mesatare e studimeve 9.00**), duke mbrojtur punimin e magjistraturës me titull: *„Interferencat ndërmjet gjuhës gjermane dhe shqipe te folësit shqiptar në Zvicër,,* dhe ka fituar gradën shkencore: *Magjistër i shkencave në fushën e filologjisë.*

Për arsye të ndërmjetësimit të suksesshëm ndërkulturor midis popullit zviceran dhe komunitetit shqiptar që jeton në Zvicër, me propozim të Këshillit qeveritar të Kantonit të Soloturnit, Dr. sc. Gjuliano Iseini më 29 nëntor 2005 është zgjedhur Përfaqësues i emigrantëve në Komisionin e integritetit të huajve në periudhën 2005 – 2009.

Në vitin 2008 kandidati Dr. sc. Gjuliano Iseini është regjistruar në studimet e doktoraturës në Fakultetin Filologjik “Blazhe Koneski” në Shkup dhe më 13. 03. 2018 me sukses e ka mbrojtur disertacionin e doktoraturës me titull: *Gjuhët në kontakt: Ndërrimi dhe përzierja e kodeve*

gjuhësore (Code-Switching/Code-Mixing) ndërmjet gjuhës shqipe dhe gjuhës gjermane në Zvicër dhe ka fituar gradën shkencore: **Doktor i shkencave në fushën e filologjisë.**

VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Në vitin shkollor 1999/2000, ka punuar profesor i gjuhës gjermane në Gjimnazin “Zef Lush Marku” në Shkup dhe në Shkollën e mesme shtetërore për ekonomi dhe byrotehnikë “Arseni Jovkov” në Shkup.

Në vitin akademik 2011/12, ka qenë i angazhuar asistent për lëndët: Gjuhë e sotme gjermane 1 dhe 2, si dhe Fonetika e gjuhës gjermane 1 në programin studimor: Gjuhë dhe letërsi gjermane në Universitetin e Tetovës.

Në vitin akademik 2012/13 ka mbajtur lëndët: Gjuhë e sotme gjermane 3 dhe 4, si dhe Fonetika e gjuhës gjermane 2 në Universitetin e lartpërmendur;

Në vitin akademik 2013/14, ka mbajtur lëndët: Morfologjia e gjuhës gjermane 1 dhe 2, si dhe

Bazat e metodikës të gjuhës gjermane në Universitetin e lartpërmendur;

Në vitin akademik 2014/15, ka mbajtur lëndët: Bazat e metodikës të gjuhës gjermane, Sintaksa 2 dhe Metodika e mësimdhënies të gjuhës gjermane në Universitetin e lartpërmendur.

Në vitin akademik 2012/13 ka qenë i angazhuar asistent për lëndët: Kultura dhe civilizimi (gjerman) 1, Gjuha gjermane 3B dhe 4B, si dhe Terminologjia profesionale e përkthimit dhe interpretimit (gjermane, mjekësia) në Katedrën për përkthim dhe interpretim të Fakultetit Filologjik “Blazhe Koneski” në Shkup.

Në vitin akademik 2017/18, ka qenë i angazhuar mësimdhënës për lëndët: Civilizimi austriak dhe zviceran dhe Fjalëformimi në studimet deridiplomike, si dhe për lëndët: Linguistika kontrastive dhe Linguistika aplikative në studimet master në Katedrën e gjuhës gjermane në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë.

Në vitin e tanishëm akademik 2018/19, është i angazhuar mësimdhënës për lëndët: Historia dhe kultura e vendeve gjermanishtfolëse në Katedrën e gjuhës gjermane të Fakultetit Filologjik, Universiteti i Tetovës.

KONFERENCAT SHKENCORE

Nga 15 deri 25 maj 2000 pjesëmarrës në Seminarin e DAAD Beograd, në Shkup për mësimdhënësit e Shoqatës së Arsimitarëve të Gjuhës Gjermane në Maqedoni.

Nga 7 deri 8 maj 2012 ka marrë pjesë në “Ditët austriake” në Tetovë, të mbajtura në Fakultetin Filologjik të Universitetit Shtetëror të Tetovës, të organizuara nga Ministria federale e arsimit, artit dhe kulturës së Austrisë.

Nga 17 deri 19 tetor 2013 ka marrë pjesë në Konferencën e 6-të të Shoqatës së Gjermanistëve të Evropës Juglindore (SOEGV) në Prishtinë, R. e Kosovës me temën: „**Deutsch aus der Perspektive der in der Schweiz lebenden Albaner – Code-Switching und Code-Mixing als Interaktionsphänomene**„.

PUNIMET SHKENCORE

1. Iseini, Gj.: Willkommen in Solothurn. Veröffentlichungen der Regierung des Kantons Solothurn, 2009.
2. Iseini, Gj.: Interferenca gjuhësore në mes shqipes dhe *gjermanishtes në Zvicër* Jahrbuch BISHZ/VAIS Bern, 1998.
3. Iseini, Gj.: Code-Switching und Code-Mixing als kulturspezifische Erscheinung in alltäglichen Gesprächssituationen zwischen den Deutschen und Albanern in der Schweiz. (pranuar në librin e abstrakteve në konferencën vjetore të Fakultetit Filologjik në UT 2018)
4. Çeliku, A./ Iseini, Gj.: Realizimi i koherencës së tekstit përmes imazhit pamor në diskursin politik në Maqedoni. (pranuar në librin e abstrakteve në konferencën vjetore të Fakultetit Filologjik në UT 2018)

Gjuhët e huaja:

Shqipe (gjuhë amtare), maqedonase, gjermane dhe angleze

2. Dr. sc. Drita Xhemali

TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Kandidatja Dr. sc. Drita Xhemali është lindur më 10.10.1966 në Prizren, Republika e Kosovës.

Studimet themelore në fushën e Gjuhës dhe letërsisë gjermane i ka kryer në Universitetin e Tetovës në vitin 2007, studimet e magjistraturës në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës në fushën e shkencave politike në vitin 2011 dhe ka fituar gradën shkencore: **Magjistër i shkencave politike**, kurse studimet e doktoraturës në Fakultetin filologjik të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup me temë: Aspekti leksikor dhe morfosintaksor gjatë mësimin të gjuhës gjermane nga nxënësit me gjuhë amtare shqipe në arsimin fillor në Maqedoni dhe ka fituar gradën shkencore: **Doktor në fushën e shkencave humane**.

Nga CV-ja e saj e paraqitur ekzistojnë të dhëna se ka marrë pjesë në disa punëtori vendore dhe jashta vendit, po ashtu se ka publikuar edhe disa punime në disa punëtori në Shkup, megjithatë kandidatja:

Dr. Sc. Drita Xhemaili, në përputhje me dokumentacionin e deponuar nga ana e saj sipas konkursit publik, rezulton se ka një përvojë si arsimtare e gjuhës gjermane në ciklin e ulët arsimor, por nuk ka përvojë mësimdhënieje në ndonjë institucion të lartë arsimor. Gjithashtu, në dosjen e paraqitur të kandidatës Dr. Sc. Drita Xhemaili ka mungesë të theksuar të dokumenteve të kërkuara në bazë të konkursit si:

1. Mungon diploma e studimeve deridiplomike
2. Mungon diploma e studimeve master
3. Mungojnë certifikatat e notave të studimeve deridiplomike dhe të masterit, gjë që e pamundëson verifikimin e notës mesatare të kërkuar me Ligjin për arsim të lartë (neni 166, pgf. 1, pika 1)
4. Në bazë të konkursit publik, pika 3, në të cilën thuhet: „Kandidatët që konkurojnë duhet të kenë kontinuitet të studimeve“, rezulton se kandidatja Dr. Sc. Drita Xhemaili nuk e plotëson këtë kusht, sepse ajo ka magjistruar në fushën e shkencave politike.
5. Po ashtu, në bazë të Ligjit për arsim të lartë, neni 164, pgf. 1, pika 3, i cili e përcakton edhe njërin ndër kushtet kryesore për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore dhe sipas të cilit kërkohen „rezultate dhe përvoja në veprimtarinë mësimore dhe përgatitje të kuadrove të reja mësimore dhe shkencore-hulumtuese“, kusht që kandidatja Dr. Sc. Drita Xhemaili nuk e plotëson, ngaqë ajo nuk ka përvojë mësimdhënieje në ndonjë institucion të lartë në vend dhe jashtë vendit.

Përfundim: Si rrjedhojë e mosplotësimit të këtyre kriterëve të përcaktuara me Statutin e Universitetit të Tetovës dhe Ligjit për arsim të lartë të R. së Maqedonisë, kandidatja Dr. Sc. Drita Xhemaili nuk i plotëson kushtet formale juridike për t'u zgjedhur në thirrjen mësimore-shkencore, sipas konkursit të shpallë publik.

PROPOZIM - VENDIM

Duke pasur parasysh përvojën kërkimore-shkencore dhe profesionale, veprimtarinë në fushën e arsimit dhe kulturës në përgjithësi, si dhe punën si bashkëpunëtor në Programin studimor: Gjuhë dhe letërsi gjermane të Fakultetit filologjik të Universitetit të Tetovës, kontributin e çmueshëm në ngritjen dhe zhvillimin e degës së gjermanistikës në UT, po ashtu mësimdhënien në Universiteti "Shën i Kirili dhe Metodi" dhe në Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë, dhe më në fund prirjen, përvojën dhe kreativitetin e tij, qoftë si krijues shkencor, qoftë si pedagog, anëtarët e Komisionit kanë kënaqësinë që Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës t'i

propozojnë që Dr. sc. Gjuliano Iseinin ta zgjedhë në thirrjen mësimore: **Docent** për lëndët: *Metodika e mësimdhënies së gjuhës gjermane, Historia dhe kultura e vendeve gjermanishtfolëse, Hyrje në gjuhësinë gjermane* në Programin studimor: Gjuhë dhe letërsi gjermane të Fakultetit filologjik të këtij universiteti.

Komisioni recensues vlerëson se kandidati në fjalë i plotëson të gjitha kriteret shkencore dhe profesionale të parapara me Ligjin për arsim të lartë, Statutin e UT-së, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore dhe thirrje të bashkëpunëtorëve, dhe aktet tjera normative, për t'u zgjedhur në këtë thirrje mësimore-shkencore.

Tetovë, më 26.11. 2018

Komisioni recensues:

- 1. Prof. dr. Arbër Çeliku (kryetar) - profesor ordinar**
- 2. Prof. dr. Brikena Kadzadej (anëtar) - profesor ordinar**
- 3. Doc. dr. Majlinda Nuhiu (anëtar) – profesor inordinar**

S H T O J C Ë

PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati: Gjuliano Iseini

Institucioni: Fakulteti filologjik, programi studimor: Gjuhë dhe letërsi gjermane – UT, Tetovë

Lëmia shkencore: Gjuhësi gjermane

I. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

| Nr. | Emri i aktivitetit: | Pikët |
|------------|----------------------------|--------------|
|------------|----------------------------|--------------|

| rendor | | |
|---|--|--|
| I.1 | Mbajtja e ligjëratave (lëndët në ciklin e parë të studimeve) | 41.2 |
| | Metodika e gjuhës gjermane I, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 4 semestër, 3+2, Universiteti Tetovës | $3 \times 15 \times 4 \times 0.04 = 7.2$ |
| | Metodika e gjuhës gjermane II, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 4 semestër, 3+5, Universiteti Tetovës | $3 \times 15 \times 4 \times 0.04 = 7.2$ |
| | Bazat e metodikës I, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 3 semestër, 2+1, Universiteti Tetovës | $2 \times 15 \times 3 \times 0.04 = 5.4$ |
| | Bazat e metodikës II, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 3 semestër, 2+1, Universiteti Tetovës | $2 \times 15 \times 3 \times 0.04 = 5.6$ |
| | Hyrje në metodikën e mësimdhënies së gjuhës gjermane (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 2 semestër, 3+0, Universiteti Tetovë | $3 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 3.6$ |
| | Fonetika e gjuhë gjermane I, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 1 semestër 2+1, Universiteti Tetovës | $2 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.2$ |
| | Fonetika e gjuhë gjermane II, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 1 semestër 2+2, Universiteti Tetovë, | $2 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.2$ |
| | Morfologjia e gjuhës gjermane I, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 2 semestër 2+1, Universiteti Tetovës | $2 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 3.6$ |
| | Gjuha gjermane 3B, (Fakulteti Filologjik Blazhe Koneski) 1 semestër 2+1 UKIM | $2 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.2$ |
| | Gjuha gjermane 4B, (Fakulteti Filologjik Blazhe Koneski) 1 semestër 2+1 UKIM | $2 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.2$ |
| | Kultura dhe civilizimi (gjerman) 1, (Fakulteti Filologjik Blazhe Koneski) 1 semestër 2+1 UKIM | $2 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.2$ |
| | Terminologjia profesionale e përkthimit dhe interpretimit (Fakulteti Filologjik Blazhe Koneski) 1 semestër 2+1 UKIM | $2 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.2$ |
| | Civilizimi austriak dhe zviceran (Katedrën e gjuhës gjermane në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit) 1 semestër 2+2 Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë | $2 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.2$ |
| | Fjalëformimi Katedrën e gjuhës gjermane në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit) 1 semestër 2+2 Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë | $2 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.2$ |
| Mbajtja e ligjëratave (lëndët në ciklin e dytë të studimeve) | 2.4 | |
| Linguistika kontrastive, Katedrën e gjuhës gjermane në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit) 1 semestër 2+2 Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë | $2 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.2$ | |
| Linguistika aplikative, Katedrën e gjuhës gjermane në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit) 1 semestër 2+2 Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë | $2 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.2$ | |
| | | |
| I.2 | Mbajtja e ushtrimeve (lëndët në ciklin e parë të studimeve) | 102,15 |
| | Fonetika e gjuhës gjermane I, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 1 semestër, 3+2, Universiteti Tetovës | $2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$ |
| | Fonetika e gjuhës gjermane II, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 1 semestër, 3+2, Universiteti Tetovës | $2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$ |
| | Metodika gjuhës gjermane I, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 2 | $2 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 1.8$ |

| | | |
|------------|--|---|
| | semestër, 3+2, Universiteti Tetovës | |
| | Metodika gjuhës gjermane II, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 2 semestër, 3+5, Universiteti Tetovës | $2 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 1.8$ |
| | Bazat e metodikës I, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 2 semestër, 2+1, Universiteti Tetovës | $2 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 1.8$ |
| | Bazat e metodikës II, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 2 semestër, 2+1, Universiteti Tetovës | $2 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 1.8$ |
| | Praktika I, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 1 semestër 1+2 | $5 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 2.25$ |
| | Gjuha e sotme gjermane I 4 semestër 0+4, Universiteti Tetovës | $4 \times 15 \times 4 \times 0.03 = 7.2$ |
| | Gjuha e sotme gjermane II 4 semestër 0+4, Universiteti Tetovës | $4 \times 15 \times 4 \times 0.03 = 7.2$ |
| | Gjuha e sotme gjermane III 4 semestër 0+4, Universiteti Tetovës | $4 \times 15 \times 4 \times 0.03 = 7.2$ |
| | Gjuha e sotme gjermane IV 4 semestër 0+4, Universiteti Tetovës | $4 \times 15 \times 4 \times 0.03 = 7.2$ |
| | Gjuha e sotme gjermane V 8 semestër 0+6, Universiteti Tetovës | $6 \times 15 \times 8 \times 0.03 = 21.6$ |
| | Gjuha e sotme gjermane VI 8 semestër 0+6, Universiteti Tetovës | $6 \times 15 \times 8 \times 0.03 = 21.6$ |
| | Gjuha e sotme gjermane VII 8 semestër 0+8, Universiteti Tetovës | $8 \times 15 \times 8 \times 0.03 = 28.8$ |
| | Gjuha e sotme gjermane VIII 8 semestër 0+8, Universiteti Tetovës | $8 \times 15 \times 8 \times 0.03 = 28.8$ |
| | Gjuhë gjermane 3 B, (Fakulteti Filologjik Blazhe Koneski) 1 semestër 2+1, UKIM | $2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$ |
| | Gjuhë gjermane 4 B, (Fakulteti Filologjik Blazhe Koneski) 1 semestër 2+1, UKIM | $2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$ |
| | Civilizimi austriak dhe zviceran (Katedrën e gjuhës gjermane në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit) 1 semestër 2+2 Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë | $2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$ |
| | Fjalëformimi Katedrën e gjuhës gjermane në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit) 1 semestër 2+2 Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë | $2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$ |
| | Historia dhe kultura e vendeve gjermanishtfolëse, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 1 semestër, 3+0, Universiteti Tetovës | $2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$ |
| | Mbajtja e ushtrimeve (lëndët në ciklin e dytë të studimeve) | 1.8 |
| | Linguistika kontrastive, Katedrën e gjuhës gjermane në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit) 1 semestër 2+2 Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë | $2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$ |
| | Linguistika aplikative, Katedrën e gjuhës gjermane në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit) 1 semestër 2+2 Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë | $2 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.9$ |
| | Konsultime me studentë | 15.352 |
| I.3 | Metodika gjuhës gjermane I, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 3 semestër, 3+2 | $30 \times 3 \times 0.002 = 0.18$ |
| | Metodika gjuhës gjermane II, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 3 semestër, 3+5 | $30 \times 3 \times 0.002 = 0.18$ |
| | Bazat e metodikës I, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 3 semestër, 2+1 | $35 \times 3 \times 0.002 = 0.21$ |
| | Bazat e metodikës II, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 3 semestër, 2+1 | $35 \times 3 \times 0.002 = 0.21$ |
| | Hyrje në metodikën e mësimdhënies së gjuhës gjermane | $24 \times 1 \times 0.002 = 0.048$ |

| | |
|--|-----------------------------------|
| (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 1 semestër, 3+0 | |
| Fonetika e gjuhës gjermane I, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 1 semestër, 3+2, Universiteti Tetovës | $35 \times 3 \times 0.002 = 0.21$ |
| Fonetika e gjuhës gjermane II, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 1 semestër, 3+2, Universiteti Tetovës | $35 \times 3 \times 0.002 = 0.21$ |
| Civilizimi austriak dhe zviceran (Katedrën e gjuhës gjermane në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit) 1 semestër 2+2 Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë | $80 \times 1 \times 0.002 = 0.16$ |
| Fjalëformimi Katedrën e gjuhës gjermane në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit) 1 semestër 2+2 Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë | $80 \times 2 \times 0.002 = 0.16$ |
| Praktika I, (Fakulteti Filologjik-Gj. gjermane) 1 semestër 1+2 | $30 \times 1 \times 0.002 = 4$ |
| Gjuha e sotme gjermane I 4 semestër 0+4 | $60 \times 4 \times 0.002 = 4$ |
| Gjuha e sotme gjermane II 4 semestër 0+4 | $40 \times 4 \times 0.002 = 0.08$ |
| Gjuha e sotme gjermane III 4 semestër 0+4 | $40 \times 4 \times 0.002 = 0.08$ |
| Gjuha e sotme gjermane IV 4 semestër 0+4 | $40 \times 4 \times 0.002 = 0.08$ |
| Gjuha e sotme gjermane V 8 semestër 0+6 | $35 \times 8 \times 0.002 = 0.08$ |
| Gjuha e sotme gjermane VI 8 semestër 0+6 | $35 \times 8 \times 0.002 = 0.12$ |
| Gjuha e sotme gjermane VII 8 semestër 0+8 | $30 \times 8 \times 0.002 = 0.12$ |
| Gjuha e sotme gjermane VIII 8 semestër 0+ 8 | $30 \times 8 \times 0.002 = 0.12$ |
| Gjuhë gjermane 3 B, (Fakulteti Filologjik Blazhe Koneski) 1 semestër 2+1, UKIM | $40 \times 1 \times 0.002 = 0.08$ |
| Gjuhë gjermane 4 B, (Fakulteti Filologjik Blazhe Koneski) 1 semestër 2+1, UKIM | $40 \times 1 \times 0.002 = 0.08$ |
| Linguistika kontrastive, Katedrën e gjuhës gjermane në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit) 1 semestër 2+2 Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë | $40 \times 1 \times 0.002 = 0.08$ |
| Linguistika aplikative, Katedrën e gjuhës gjermane në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit) 1 semestër 2+2 Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë | $40 \times 1 \times 0.002 = 0.08$ |
| | |
| Gjithsej (I.1-I-3): | 160,502 |

II. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

| Nr. Rendor | Emri i aktivitetit: | Pikët |
|------------|--|-----------|
| II.3 | Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në përmbledhjen e punimeve të konferencës shkencore me bord redaktues ndërkombëtar | 11 |
| | 1. Iseini, Gj.: Willkommen in Solothurn. Veröffentlichungen der Regierung des Kantons Solothurn, 2009. | 2x3+2 |
| | 2. Iseini, Gj.: Interferenca gjuhësore në mes shqipes dhe gjermanishtes në Zvicër, Jahrbuch BISHZ/VAIS Bern, 1998. | |

| | | |
|-------------|--|-----------|
| | <p>3. Iseini, Gj.: Code-Switching und Code-Mixing als kulturspezifische Erscheinung in alltäglichen Gesprächssituationen zwischen den Deutschen und Albanern in der Schweiz. (pranuar në librin e abstrakteve në konferencën vjetore të Fakultetit Filologjik në UT 2018)</p> <p>4. Çeliku, A./ Iseini, Gj.: Realizimi i koherencës së tekstit përmes imazhit pamor në diskursin politik në Maqedoni. (pranuar në librin e abstrakteve në konferencën vjetore të Fakultetit Filologjik në UT 2018)</p> | |
| | Pjesëmarrje në takime shkencore me kumtesë | 1 |
| | Gjuliano Iseini , Deutsch aus der Perspektive der in der Schweiz lebenden Albaner – Code-Switching und Code-Mixing als Interaktionsphänomene. Universiteti i Prishtinës, konferencë shkencore ndërkombëtare në organizim të Shoqatës së Gjermanistëve të Evropës Juglindore (SOEGV) në Prishtinë, R. e Kosovës | 1 |
| II.3 | | |
| II | Gjithsej (II.1-II-3): | 11 |

III. VEPRIMTARI PROFESIONALE-APLIKATIVE

| Nr. rendor | Emri i aktivitetit: | |
|-------------------|--|-----------|
| III.1 | Anëtar i komisionit universitar | 2 |
| | Anëtar i komisionit për vlerësim ose mbrojtje të punimit të diplomës | 2 |
| III.2 | Udhëheqës | 0 |
| | Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit | 12 |
| III.3 | Ditët e hapura, USHT 2010/11/12/13/14/15/16/17/18 | 9 |
| | Promovim i Fakultetit Filologjik nëpër shkolla të mesme 2015/2016 | 3 |

| REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE | Pikët |
|---|----------------|
| VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE | 160,502 |
| VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE | 11 |
| VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE | 14 |
| Gjithsej | 182.502 |

Tetovë, 26.11.2018

Komisioni recensues:

- 1. Prof. dr. Arbër Çeliku (kryetar) - profesor ordinar**
- 2. Prof. dr. Brikena Kadzadej (anëtar) - profesor ordinar**
- 3. Doc. dr. Majlinda Nuhii (anëtar) – profesor inordinar**